



## Thirrje për pjesmarrje në trajnim për analizë dhe monitorim të politikave për zhvillim rajonal

Forum - Qendra për hulumtime strategjike dhe dokumentim dhe Inicijativat rinore për dijalog dhe bashkëpunim ftojnë të gjithë të interesuarit të paraqiten për pjesmarrje në trajnimin për monitorim të politikave për zhvillim rajonal dhe përfaqësim për zhvillim rajonal të balancuar, në kuadër të projektit Aleanca për zhvillim rajonal, i mbështetur financiarisht nga Unioni European nëpërmjet programit EIDHR 2014-2015. Në këtë trajnim mund të paraqiten të gjithë të interesuarit të cilët shprehin interes për zgjerim të njohurive të tyre nga kjo lëmi dhe të cilët kanë njohuri të caktuara në lidhje me temat të ndërlidhura me decentralizimin dhe zhvillimin rajonal.

Kandidatët e përzgjedhur do të kenë mundësi të kycen në aktivitetet e ardhëshme të Aleancës për zhvillim rajonal, paraprakisht me mundësinë për hulumtin të disa aspekteve të ndërlidhura me implementimin e politikave për zhvillim rajonal të balancuar, e cila financiarisht do të mbështetet nga Aleanca për zhvillim rajonal.

Realizimi i programit do të mbahet nga 17 deri 19 Mars në Hotel Romantik, Veles. Për t'u arritur qëllimet e programit dhe që të marrin certifikatë për pjesmarrje në trajnim, nga kandidatët e paraqitur kërkohet përgatitje për punë ekipore dhe rregullshmëri gjatë gjithë trajnimit.

Për kuptim më të mirë të nevojave të kandidatëve për pjesmarrje në trajnim është e nevojshme që të përgjigjen në pyetjet më poshtë:

1. Cilat janë përvojat e deritanishme të lidhura me temat nga fusha e decentralizimit, zhvillimit lokal apo rajonal?
2. Si njohuritë e fituara nga trajnimi do t'i shfrytëzoni në aktivitetet e juaja të ardhëshme?
3. Ndani një fushë specifike të interesit të lidhur me temën e zhvillimit rajonal.

Bashkë me këto përgjigje, është e nevojshme kandidatët të dërgojnë dhe biografi të shkurtë në adresën elektronike: [mihajlovska@forum-csrd.org.mk](mailto:mihajlovska@forum-csrd.org.mk) më vonë deri 13 Mars 2017.

Pasi që numri I pjesmarrësve në trajnim është i kufizuar, do të bëhet seleksionim i kandidateve të cilët do të jenë të ftuar në trajnim. Përparësi do të kenë kandidatët të cilët janë antarë aktiv të organizatave qytetare apo grupeve joformale të cilët kanë implementuar projekte, hulumtime apo inicijativa të lidhura me decentralizimin dhe zhvillimin lokal. Gjithashtu, do të jepet mundësi që në trajnim të ketë pjesmarrës nga cdo rajon planor, nga 8 gjithsej që janë.

Më së shumti nga dy përfaqësues nga organizata e njejtë mund të jenë të ftuar në trajnim, kurse gjatë selektimit të kandidatëve kujdes të vecantë do t'i përkushtohet barazisë gjinore dhe kycjes së përfaqësuesve të pakicave dhe grupeve të marginalizuara.



Проектот е финансиран од Европската Унија

Форум Центар за стратегиски истражувања и документација (ЦСИД) и Младински иницијативи за дијалог и соработка (МИДС)



Trajnimet do të mbahen në gjuhën maqedone, kurse prezentues do të jenë trajnues të shquar për decentralizim dhe zhvillim rajonal me përvojë të madhe në monitorim të politikave për zhvillim rajonal dhe me eksperiencë të madhe bashkëpunimi me pushtetin lokal, nacional dhe institucionet rajonale të cilat kanë ingerenca për implementim të politikave për zhvillim rajonal.

Harxhimet për pjesmarrësit në trajnim do të mbulohen nga organizatorët.



**Проектот е финансиран од Европската Унија**

**Форум Центар за стратешки истражувања и документација (ЦСИД) и Младински иницијативи за дијалог и соработка (МИДС)**